

Unë **Fatmir Rashti** jam i lindur më 2. 5. 1958 në fshatin Petrovë të Shtimes. Do të jem kandidat i pavarur për kryetar të Komunës së Shtimes në zgjedhjet lokale të 22 tetorit. Si kandidatë i pavarur do të kam mbështetjen e fuqishme nga anëtarësia dhe simpatizantët e të gjitha subjekteve politike garuese, shoqërisë civile dhe qytetarëve të komunës së Shtimes.

Me programin tim politik rëndësi të veçantë do t'i jap zhvillimit ekonomik përmes të të cilit do të rritet mirëqenia e qytetarëve në të gjitha fushat e jetës duke përmirësuar në përgjithësi cilësinë dhe shërbimet ndaj qytetarëve. Pikënisje për një përkufizim të ri të Shtimes duhet të gjendet tek krijimi i vendeve të reja të punës përmes zhvillimit të sektorit të arsimit, shëndetësisë, ekonomisë, bujqësisë e tjerë.

Gjatë mandatit tim katërvjeçar prioritet në vete do të jetë rritja e cilësisë së arsimit dhe veçanërisht atij profesional në mënyrë që të rinjtë të dalin të sigurtë në tregun e punës. Pra, ky është një prioritet madhor dhe kusht i rëndësishëm për përgatitjen e forcës së punës për tregun e punës kudo në Kosovë dhe jashtë vendit. Me qeverisjen time, Shtimja do të jetë një komunë e sigurtë për jetën, shëndetin, arsimimin dhe punën e çdo individ duke garantuar barazinë gjinore dhe pjesëmarrjen e rinisë në strukturat e saj dhe vendim-marrje. Në çdo institucion komunal shtetëror do të përmirësoi shërbimet komunale karshi qytetarëve me një transparencë të lartë dhe llogaridhënie për paranë publike.

Në të gjitha institucionet komunale do të ketë një kulturë të re të respektit ndaj ligjit dhe zbatimit të tij në përpikmëri. Për mua si kryetar komune do të thotë garantim i sigurisë juridike për çdo qytetarë, në mënyrë të barabartë, efçente dhe të përgjegjëshme duke organizuar drejtësinë si një shërbim të sigurtë e të arritshëm nga të gjithë, dhe duke respektuar të drejtat e qytetarëve si të patjetërsueshme.

Një gjë tjetër shumë me rëndësi që do të ndodhë në komunën tonë është investimi në kapitalin njerëzor, i cili përbën investimin më rentabël të çdo shoqërie dhe garanton një qeverisje lokale efikase. Ne synojmë të ecim më shpejt në procesin e politikë-bërjes që ka qëllim parësor vetëm interesin e qytetarëve dhe jo interesin e ngushtë të klaneve dhe politikës ditore. Për arritjen e tyre është mëse e domosdoshme edhe konsolidimi i shërbimit civil dhe rritja e profesionalizimit të administratës komunale, si faktor jetik për zhvillimin e gjithmbarshëm të komunës së Shtimes.

Punësimi i të rinjëve do të jetë objektivi im madhor, të cilin do të synojë ta bëjë përmes zhvillimit ekonomik duke krijuar politika nxitëse për biznesin, veçanërisht agrobiznesin si sektori me potencialin më të madh për punësim, dhe do të kemi si rezultat përfundimtar rritjen e punësimi.

Gjatë fushatës time, do të mundohem të jam sa më korrekt e tolerantë me të gjithë kandidatët potencial për kryetar dhe nuk do të veprojnë në atë mënyrë që do të nënkuptonte qërim hesapesh me kandidatët pretendent për kryetar komune apo me subjektet e tyre politike.

